

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët Emine Mustafa kryetare e kolegjit, Avdi Dinaj dhe Nebojša Boričić anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Mirlinda Mejzini procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të pandehurve L. B. dhe A. B., për shkak të dyshimit të bazuar se kanë kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 pika 1.1 lidhur me nenin 31 të KPK, duke vendosur lidhur me kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësve të të pandehurve L. B. dhe A. B., paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtri PPR.nr.74/2016 të datës 18.07.2016 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN.1.nr.1265/2016 të datës 22.07.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur më 18.08.2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me aprovimin e kërkesave për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësve të të pandehurve L. B. dhe A. B., ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtri PPR.nr.74/2016 të datës 18.07.2016 dhe aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN.1.nr.1265/2016 të datës 22.07.2016, dhe ndaj të pandehurve L. B. dhe A. B. ndërpritet masa e paraburgimit dhe të njëjtit lirohen menjëherë për tu mbrojtur në liri.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtri Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Penal, me aktvendimin PPR.nr.74/2016 të datës 18.07.2016, të pandehurve L. Bunjaku dhe A. B., për shkak të dyshimit të bazuar se kanë kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga

neni 188 par.1 pika 1.1 lidhur me nenin 31 të KPK, ia ka caktuar masën e paraburgimit për 1 (një) muaj e cila do të llogaritet nga data 17.07.2016 deri më 17.08.2016. Masa e paraburgimit është caktuar në bazë të nenit 187 par.1 nënpar. 1.2 pikat 1.2.3 të KPPK-së.

Në procedurën ankimore, gjykata e Apelit e Kosovës me aktvendimin PN.1.nr.1265/2016 të datës 22.07.2016, i ka refuzuar si të pabazuara ankesat e mbrojtësve të të pandehurve dhe e ka vërtetuar aktvendimin e shkallës së parë.

Paraqitësi i kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë dhe pretendimet e tij.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kanë ushtruar mbrojtësi i të pandehurit L. B., av. A. P., dhe mbrojtësi i të pandehurit A. B, av.B. M., për shkak të shkeljes së të drejtës e cila i njihet palës me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, të drejtës thelbësore të palës të paraparë me KPP dhe të drejtës procedurale të garantuara me dispozitat e përgjithshme të KPP, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta ndërpres paraburgimin dhe të pandehurit të mbrohen në liri.

Në kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë, të cilat janë identike, mbrojtësit kryesisht theksojnë se aktvendimet e atakuara kanë një mori shkeljesh esenciale të dispozitave të procedurës penale, se dispozitivi i aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë nuk përputhet me arsyetimin e saj ngase në dispozitiv është cekur se paraburgimi caktohet në bazë të pikës 1.2.3. të nenit 187 të KPPK, ndërsa në pjesën e arsyetimit ipen arsyet edhe për pikën 1.2.2. të cilën pikë Prokurori nuk e ka kërkuar fare në kërkesën për caktimin e paraburgimit, ndërsa Gjykata e Apelit e ka vërtetuar aktvendimin e shkallës së parë duke mos dhënë asnjë arsye të veçantë në lidhje me pretendimet e ngritura në ankesa, se palët janë pajtuar dhe kanë nënshkruar procesverbalin e pajtimit, dhe se në praktikën e Gjykatave nuk ka ndodhur asnjëherë të caktohet paraburgimi për këtë vepër penale.

Opinioni i Prokurorit të Shtetit lidhur me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Prokurori i Shtetit i Kosovës, me shkresën KMLP.III.nr.44/16 të datës 11.08.2016, ka propozuar që kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësve të të pandehurve L. B. dhe A. B. të refuzohen si të pabazuara.

Gjetjet e Gjykatës Supreme

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi pretendimet e kërkesave, dhe gjeti se:

- kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë janë të bazuara.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate pretendimet e mësipërme ankimore janë të bazuara për arsye si në vijim: aktvendimet e atakuara me kërkesat janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, me çka me të drejtë kanë tërhequr vërejtjen edhe të mbrojtësit, ngase nuk ka arsye të mjaftueshme dhe bazë ligjore që të pandehurve në fjalë tu caktohet masa e paraburgimit për faktin se arsyet që i ka dhënë gjykata e shkallës së parë e që pothuajse i ka përshkruar edhe gjykata e shkallës së dytë janë konfuze dhe pa arsyetim konkret, ngase për të përmbushur njëri nga kushtet për caktim të paraburgimit duhet të përmbushen kushtet e përcaktuara nga neni 187 par.1 nën par.1.1 dhe 1.2 pika 1.2.3 të KPPK-së.

Në bazë të analizimit nga aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë për caktim të paraburgimit dhe ai i shkallës së dytë si dhe pretendimeve të parashtruara në kërkesat e mbrojtësve qartë shihet se nuk ekzistojnë asnjëra nga kushtet për caktim të paraburgimit, ngase në rastin konkret kemi të bëjmë me veprën penale me peshë relativisht të lehtë, se janë familjarë në mes veti dhe janë pajtuar me të dëmtuarit Sh. B. dhe Xh. B. duke e nënshkruar edhe aktin - procesverbalin mbi pajtimin të datës 19.07.2016 të vërtetuar në Gjykatën Themelore në Mitrovicë- dega në Vushtrri, duke deklaruar se në të ardhmen do të jetojnë pa pasur probleme dhe mosmarrëveshje, andaj nuk ka arsye që të pandehurit në fjalë të qëndrojnë në paraburgim pasi që masa e paraburgimit mund të shqiptohet vetëm në situata të jashtëzakonshme, kur asnjë masë tjetër alternative nuk do kishte efekte, në drejtim të zhvillimit të një procesi të rregullt penal, dhe nuk do mund në parandalonte përsëritjen e veprës penale.

Mënyra dhe rrethanat e kryerjes së veprës penale, pesha dhe lloji i veprave penale janë tog shprehjesh që i ka ndërtuar ligjdhënësi dhe arsye për caktimin e paraburgimit për bazën e mundësisë së përsëritjes së veprës penale, mirëpo me rastin e caktimit të paraburgimit për cilëndo nga këto arsye, gjykata ka për detyrim ta vë në pah qartë se pse ndonjëra nga këto

rrethana e bëjnë frikën të bazuar? E jo vetëm ta parafrazoj rrethanën ashtu siç e ka parafrazuar ligji pa dhënë sqarime fare, si kanë vepruar gjykatat në rastin konkret. Rrethanat konkrete me rastin e vazhimit të paraburgimit nga kjo bazë gjykatat duhet t'i ketë pasur parasysht: llojin dhe peshën e veprës penale, sjelljet e mëparshme të të pandehurve, karakterin e raporteve midis të pandehurve, vetit personale, karakteri personal, sjelljet e mëparshme, kushte në të cilat jetojnë të pandehurit etj.

Nga kjo rezulton se gjykata e shkallës së parë e as ajo e shkallës së dytë nuk ka dhënë arsye për faktet vendimtare që kanë bëjnë me bazën ligjore për caktimin e paraburgimit që kushtëzuan ndryshimin e aktvendimeve të atakuara me kërkesë.

Për arsyet e lartcekura e në bazë të nenit 438 par. 1 nënpar.1.1 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË

Pml.nr.210/2016 datë 15.08.2016.

Procesmbajtësja,
Mirlinda Mejzini

Kryetare e kolegjit,
Emine Mustafa